



PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) - Rahovec, e mbajtur më 06.06.2023, me fillim në ora 15:00. Mbledhjen e kryesoi Kryetari Komunës zt. Smajl Latifi. Për mbajtjen e mbledhjes kuorumi ekziston.

Kryetari - Më lejoni t'i përshëndes anëtarët e KKSBB-së, përshëndes nënkyetarin e Komunës zt. Fatmir Iska, drejtoret e drejtive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovec, zt. Fazli Morina, përfaqësuesit e bashkësive fetare, përfaqësuesit e OSBE-së, UNMIK-ut, KFOR-it, LMT-së dhe mediat. Është mbledhja e tretë e rregullt për vitin 2023. Përkëtë mbledhje propozoj këtë:

Rend Dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;
 - Prishja e qetësë publike nga lokalet e natës dhe personat e papërgjegjshëm;
 - Plani operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe dasmave;
 - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit;
 - Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit;
 - Siguria ne trafik;
 - Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore.
3. Identifikimi i çështjeve problematike që ndikojnë në sigurinë publike ndëretnike;
4. Të ndryshme.

Kryetari – Atëherë, a ka dikush ndonjë koment rreth rendit të ditës?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”... Kundër?... Abstenim?... Konstatojmë që është miratuar me shumicë votash.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryetari – A ka dikush ndonjë koment ose vërejtje rreth procesverbalit të mbledhjes së kaluar?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim! Kush është “për”?... Me shumicë të votave, miratohet pika e parë e rendit të ditës.

2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;

Kryetari – Për detaje do ta marrë fjalën komandanti i stacionit zt. Fazli Morina, por mund të konstatojmë që situa e sigurisë ndërmjet dy takimeve, ka vazhduar të jetë e qetë dhe stabile. I kemi edhe nënpikat e pikës së dytë për të cilat do të flasim në vazhdim.

Fazli Morina – I nderuar kryetar! Të nderuar anëtarë të KKSBB-së, LMT, OSBE, UNMIK-u (Pejë), drejtore të drejtive. Duke iu referuar të gjitha nënpikave të rendit të ditës që i potencoi kryetari, sipas raportit mujor e kemi bërë një përbledhje të shkurtër. Gjatë kësaj kohe është implementuar një urdhër operativ në veri të vendit, katër plane operative, tri projekte për siguri në komunikacion dhe një projekt për parandalimin e dukurive të zjarrit. Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 60 raste vepra penale dhe 4 incidente jopenale, nga këto janë lëndime të rënda një rast, të lehta 5 raste, vjedhje 3 raste, vjedhje të rënda 11 raste, dhunë në familje 6 raste, substanca narkotike 1, keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare 2 raste, armëmbajtje pa leje 1 rast, nxitje të urrejtjes 1 rast, persona të

arrestuar 14, prej tyre në mbajtje janë 8. Urdhëresa të gjykatës 23 raste, aksidente me dëme materiale 14 raste. Te siguria në trafikun rrugor vazhdon lirimi i hapësirave publike nga automjetet e paregjistruara, të dëmtuara dhe të tjera. Për kundërvajtje në komunikacion rrugor janë shqiptuar 589 gjoba, 143 për parkingje joadekuate, 29 gjoba për vozitje pa patent-shofer dhe 13 gjoba për prishje të rendit dhe qetësisë publike. Sa i përket sigurisë në shkolla janë zhvilluar disa aktivitete dhe plane operative duke ndikuar në ngritjen e përgjithshme të sigurisë për nxënësit. Janë mbajtur ligjëratë teorike dhe praktike për nxënësit e katër shkollave fillore, me temën: Sensibilizimi i pjesëmarrësve në komunikacion dhe parandalimi i aksidenteve me lëndime trupore dhe fatalitet. Në prezantimin e kësaj temë, janë përfshire rreth 80 nxënës prej klasës 5 deri 8. Sa i përket incidenteve në shkolla, gjatë periudhës raportuese kanë ndodhur 4 raste, dy raste keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare dhe dy raste janë sulm. Në përashtim të situatës pak shqetësuese që është në veri, në përgjithësi është e qetë dhe stabile. Një rast i nxitjes së urrejtjes ka ndodhur në lagjen e epërmë dhe falë angazhimit të zyrtarëve policorë është arritur identifikimi dhe është bërë kallëzimi penal.

Përparim Krasniqi – Faleminderit kryetar! Përshëndetje për të gjithë. Sa i përket nënpikës rreth mbrojtjes së lumenjve: Përrockat momentalisht janë në gjendje të mirë, përkundër asaj që kohëve të fundit kemi reshje. Në disa vendbanime jemi duke punuar, në disa tjera kemi ngecje për shkak të disa problemeve specifike që kanë ndodhur në mungesë të mbështetjes financiare nga ana e nivelit qendror (Ministria e Mjedisit).

Nora Boshnjaku – Faleminderit kryetar! Përshëndetje për të gjithë. Sa i përket sigurisë së produkteve ushqimore, tanimë dihet që kontrollimi i produkteve ushqimore bëhet direkt nga inspektorët e AVUK-ut. Ne, në koordinim me ta, kemi ndërmarrë disa aksione të përbashkëta, kryesisht në sigurinë e produkteve ushqimore dhe në ndonjë mashtrim rreth çmimeve. Jemi në vazhdimësi afër qytetarëve tanë dhe nëse shihni ndonjë keqpërdorim, lajmërohuni t’i ne duke mos hezituar dhe ne do të veprojmë me kohë.

Shaip Shala – Komandant, faleminderit për raportin! Por, në fund nuk ceket se për çfarë nxitje i c’urrejtjes në lagjen e epërmë bëhet fjalë? Ju paragjykoi! Nëse është fjalë për portretin, shkarravitja në fjalë nuk i është drejtuar asnjë serbi as të Rahovecit, as të Hoçës së Madhe dhe nuk do të ndikojë në marrëdhëniet ndëretnike. Shkarravitje i është drejtuar vetëm teniserit, që ka folur nëpër mediume si ultra nationalist. Tjetër, për kontejnerin e larguar nga ajo lagje (lagjja më e madhe në qytet), nuk është çështja nëse personi gjobitet 1 herë, 2 herë ose 5, zgjidhja është të kthehet kontejneri dhe t’i bëhet e qartë atij që trotuari nuk është pronë e tij.

Fadil Sylka – Përshëndetje për të gjithë! Një pyetje për Norën: Në Viva Fresh kam hasur që çmimet e produkteve që hargjohen, nuk zëvendësohet por renditen produktet tjera në çmimet e njëjtë. Konsumatori në momenti që shkon në arkë i del çmim tjetër, kjo sjellë konfuzitet.

Nysret Abazibra – Përshëndetje kryetar, anëtarë të KKSB-së. Çështja e parë që dëshiroj të flas është prishja e qetësisë publike. Mendoj që do të ishte më mirë që te çështja e muzikës të ndërmerrët diçka, sepse gjatë tërë natës, (gjatë muajve të verës) prishja e qetësisë është diçka shqetësuese, sepse nëse dikush ka dasmë, tjerët kanë punë dhe duhet të pushojnë. Te siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore: Çështja e çmimeve mendoj që nuk është duke funksionuar si duhet, posaçërisht vendosja e çmimeve te pemët dhe perimet. Kjo është josiguri për konsumatorët. Në lagjen lart përball varrezave ortodokse, gati më shumë se një vit është një prishje dhe qarkullojnë ujërat e zeza, mirë është të ndërmerrni një hap për rregullimin e këtij problemi. Sa i përket ndriçimit në rastin e lagjes në shkollë, ende nuk është kryer! Sa i përket punimeve në qendër, punimet janë ndërprerë dhe ajo rrugë nuk është astësuar as edhe minimalisht për kalimtarët. Mirë është që përkohësisht të shtrohet zhavorr në mënyrë që të jetë e kalueshme.

Nora Boshnjaku – Faleminderit kryetar! Fillimisht për Fadilin: Sa i përket çmimeve, nuk është rasti vetëm në VivaFresh, është edhe në ETC, SuperViva dhe ndoshta në secilin market në qytet. Për rastin konkret, ankesat e konsumatorëve i trajtojmë menjëherë. Në këtë rast inspektorët nuk i kontrollojnë vetëm çmimet por kanë edhe operime të tjera. Numrin e inspektorëve e kemi shumë të vogël, për këtë arsyeshë i nevojshëm bashkëpunimi me qytetarë, të lajmërohen çoftë edhe me një fotografi. Konsumatori.rks-gov.net ose në tel. 080011000. Me bindje të plotë e them që të gjitha ankesat deri më sot i kemi të trajtuara. Sa i përket zhurmës, konkretisht sezonës së dasmave, gastronomët duhet të pajisen me leje e cila ka të bëjë rreth lejimit dhe matjes së zhurmës. E njëjtë vlen edhe për pronarët e sallave të dasmave.

Përparim Krasniqi – Faleminderit kryetar! Hoxhë, faleminderit për pyetjet! Është e vërtetë që disa rrugë alternative janë të demoluara. Sidoqoftë ne jemi në fazën e lidhjes së kontratës për merimetimin e rrugëve, besoj që do t’i trajtojmë me kujdes ato rrugë që i përmende. Sa i përket punimeve në qendër, punimet nuk janë ndaluar asnjëherë,

i kemi pasur disa vonesa për shkak të KRU-Gjakovës për zëvendësimin e gypit të azbestit për ujë të pijshëm. Në qendër të qytetit do të hiqet rjeti elektrik në shtylla dhe do të instalohet nëntokë. Në fund të qershorit, besojmë që do të përsfundojnë edhe qendra e qytetit edhe rruga "Ali Sokoli". Sa i përket gropës që e përmendi hoxha, duhet ta dërgojmë një inxhinier ta konstatojmë rrjedhjen, a është privat apo nga kanalizimi i ujërave të zeza të qytetit.

Kryetari - Gropa që e përmendi hoxha, në çoftëse është një vit dhe nuk e kemi ditur, atëherë është gabimi ynë. Për kontrollin e produkteve dhe sigurinë e çmimeve, ne nuk mund ta presim vetëm konsumatorin, por inspektorët që nga nesër do të inspektojnë për çmimin, origjinën dhe afatin e produkteve ushqimore. Sa i përket ndriçimit publik, jemi në procesin e zëvendësimit të të gjitha dritave publike, duke u vendosur drita të reja - dixhitale. Sa i përket sheshit në qender, ky projekt kryesisht financohet nga ministria e Infrastrukturës, Mbrojtjes së Mjedisit dhe Planifikimit I Hapësinor dhe ka pasur vonesë të pagesave për operatorin "Benita" që i kryen punët aty. Tani ka një zhbllokim të situatës dhe vonesa e injeteve nuk e pengon operatorin që të vazhdojë punën për ta përsfunduar sa më shpejtë projektin. Vonesat kanë qenë edhe nga KEDS-i dhe KRU Gjakova. Do të vazhdojmë me punë duke riparuar rrugët që janë të dëmtuara.

3. Identifikimi i çështjeve problematike që ndikojnë në sigurinë publike ndëretnike;

Kryetari - Do të punojmë që të mos ketë raste që prodhojnë urrejje dhe gjuhë të mosdurimit sepse marrëdhëniet ndëretnike është e vërtetë që nuk prishen me një rast ose dy, por duhet të jemi të vëmendshëm në vazhdimësi edhe këtu në KKSB ta japim kontributin tonë edhe në lagje të epërme dhe kudo në territorin e përgjegjësisë në komunën tonë. Situata në Komunën e Rahovecit vazhdon të jetë e qetë dhe stabile, përkundër klimës së përgjithshme në Kosovë, që në ndonjë vend mund të ketë edhe probleme të vogla. I stoq qytetarët që të vazhdojnë jetën normale, le t'i vishen punëve që i kanë përparrë.

4. Të ndryshme;

Përparim Krasniqi - Faleminderit kryetar! U detyrova të dal jashtë pak, për shkak të zhvillimeve të punimeve në qendër. Përmes KKSB-së, njofstoq qytetarët që sot do të bllokohet rruga aty, sepse do të punohet për ta bërë devijimin e kanalit të lumit "Duhlo".

Ilvi Shehu - Përshëndetje! Meqenëse nuk kam qenë një kohë të gjatë i pranishëm, kam dëshire të më dëgjoni. Në këtë sallë jam më i vjetri dhe të moçmit kanë thënë që "edhe zanatin e kasapit duhet ta kemi, por vaj halli ai është kasap". Kështuqë dua t'ju shfajesoj në një mënyrë juve kryetar. Prej vitin 1972, çdo njeri për interesat personale, kanë kontribuar me ndërtimë për të keq, duke ndikuar dukshëm në prishjen e planit urbanistik në qytet. Planit urbanistik ka qenë në vijë horizontale prej Komunës deri te Dardha në Blatë. I bie të jetë sfidë e madhe për kryetarin t'i përmirësojë gabimet e 50 vjetshit. Po ndërtohet infrastruktura moderne dhe po bëhen punë të mira: uji dhe kanalizimi modern nëntok, kabllot elektrike gjithashu po suten nëntokë, duke i eleminuar shtyllat. Rreth pyetjes së Hoxhës: Po i them që "shyqyr" që janë këta të kurbetit, sepse ata na bëjnë gjallëri ato dy muaj sa i kanë pushim.

Kryetari - Faleminderit për vlerësimin baca Ilvi. Sa i përket punëve, vetëm në Sheshin Qëndror investimi do të jetë mbi 4 milion € dhe rrugët në qytet 1.5 milion €. Besoj që na duhet edhe pak durim për t'i vendosur në vend dinamikat e punimeve si dhe vonesat e mundshme buxhetore, sepse ne merremi me operatorë të punimeve në baza ditore si dhe me KRU-Gjakovën dhe KEDS-in. Sa i përket lokaleve të natës: Kemi pasur aksione ndaj atyre që zakonisht kanë krijuar probleme, bashkë me inspektorët kompetent. Ndërsa këta që bëjnë zhurmë me ahengje dhe dasma, c'kanë një traditë që pajisen me leje. Kurse te dasmat që realizohen nëpër shpija, nuk e di deri në fund çfarë plani operativ ka policia, por mesiguri do ta vendosin një orar të dasmës, deri në cilën orë lejohet të mbahet ahengu, përkundër asaj që ne nuk jemi të interesuar t'ia prishim dasmën askujt. Faleminderit të gjithëve.

Procesmbajtësi

Abdullah Krasniqi



Kryetari i Komunës

Smajl Latifi